



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2018 PËR
PROJEKTIN “PROGRAMI SEKTORIAL I UJËRAVE/ FURNIZIMI ME UJË I
ZONAVE RURALE IV”**

I. HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/ furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

II. QËLLIMI DHE PERMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/ furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë marrjen e një kredie të butë nga KfW, në vlerë të përgjithshme deri në 40 000 000 (dyzet milionë) euro, dhe grant, në vlerën 2 000 000 (dy milionë) euro për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

Ky projekt synon të përmirësojë infrastr

ukturën e ujësjellësve dhe kanalizimeve, nëpërmjet sigurimit të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për popullsinë rezidente dhe turistët në zonën e projektit, me kosto sociale të pranueshme dhe tarifa që i mbulojnë kostot, si dhe të saniteteve të përshtatshme, nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe përmirësimit të kapaciteteve menaxhuese.

Duhet theksuar se menaxhimi i ujit dhe kanalizimeve vazhdon të jetë një nga problematikat dhe sfidat infrastrukturore kryesore në zonat rurale.

Fondi që parashikohet të merret nëpërmjet kredisë së butë do të përdoret për realizimin e investimeve në zonën bregdetare të jugut të Shqipërisë, duke u fokusuar në Bashkinë e Himarës dhe në Bashkinë Orikum, duke qenë se projektet për këto bashki nuk mundën dot të zbatoheshin në kuadër të fazës së tretë të programit, për shkak të fondeve të limituara. Gjithashtu bashkia e Himarës konsiderohet si një nga rajonet më të rëndësishme turistike në Shqipëri, me një potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm.

Gjatë përzgjedhjes së programit u identifikuan nevoja të konsiderueshme për investime në qytetin e Himarës dhe në fshatrat fqinje duke qenë se sistemet ekzistuese të furnizimit me ujë janë në rrjete të vjetra, që shkaktojnë humbje të ujit në shkallë të madhe, dhe puse, me një kapacitet të pamjaftueshëm për kërkesën gjithmonë e në rritje, veçanërisht gjatë sezonit veror.

Zbatimi i këtij projektligji nuk përmban efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, sepse është parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, që është dhe agjencia përgjegjëse e Zbatimit të Projektit.

Në aspektin e teknikës legislative, marrëveshja, plotëson kërkesat formale të një marrëveshjeje dhe institucioni përgjegjës për zbatimin e saj do të jetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Duke mbajtur në vëmendje se zbatimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të promovojë zhvillimin e turizmit për zonat e parashikuara.

III. DISKUTIMI NË KOMISION

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të përfaqësues të Ministrisë së Infstrukturës dhe Energjisë. Deputetët në komision u informuan rreth qëllimit të projektligjit dhe kushteve të parashikuara në marrëveshje. Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se kjo marrëveshje do të bëjë të mundur për Republikën e Shqipërisë akordimin e një fondi nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, nëpërmjet KfW-së në vlerën 40 000 000 (dyzetë milion) euro dhe një granti në vlerën 2 000 000 (dy milion) euro për masat e nevojshme shoqëruese të programit. Deputetët pasi u informuan për kushtet specifike të marrëveshjes vlerësuan bashkëpunimin me KfW-në dhe ndikimin që pritet të ketë ky fond në përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësve dhe kanalizimeve, nëpërmjet sigurimit të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për popullsinë rezidente dhe turistët në zonën e projektit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATORE

EGLANTINA GJERMENI

KRYETARE

MIMI KODHELI